



Kalendari i aktiviteteve për Javën e Parasë

12-18 mars 2018

Java e Parasë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si shumë institucione të tjera në mbarë globin organizojnë aktivitete të larmishme për t'i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, duke u mësuar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht apo si t'i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.

Organizatorë:

Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), Junior Achievement (JA).

Tema e këtij viti është: “Paraja: Ç’të mbjellësh, do të korrësh!”

E hënë, 12 mars 2018

Ora 11:00, Tiranë

Ceremonia e çeljes së Javës së Parasë do të organizohet në ambientet e Muzeut të Bankës së Shqipërisë. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave në fjalët e tyre të shkurtra përshëndetëse theksojnë ndër të tjera misionin e Javës së Parasë dhe promovojnë rëndësinë e kulturës financiare për publikun e gjerë dhe në veçanti për brezat e rinj.

Pas fjalëve të rastit, aktiviteti vijon me shpërndarjen e çmimeve për fituesit e 3 konkurseve të lançuara një muaj më parë nga BSH dhe AAB. Guvernatori Sejko, Ministrja Nikolla dhe kryetari i AAB Pedrazzi, së bashku me drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare që sponsorizojnë çmimet për fituesit e konkurseve, ndajnë çmimet dhe bëjnë foto me nxënësit dhe studentët fitues.

1. Konkursi për nxënësit e klasave VI të shkollës 9-vjeçare me projekte “Paraja: Ç’të mbjellësh, do të korrësh!”
2. Konkursi për nxënësit e shkollave të mesme “Videoja më e mirë” me temë “Paraja: Ç’të mbjellësh, do të korrësh!”
3. Konkursi për studentë i esesë më të mirë me temë “A përbën rrezik përdorimi i euros në transaksionet tregtare në Shqipëri?”



E martë, 13 mars 2018

Ora 09:00, Tiranë

Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe orë mësimore për nxënës të ciklit fillor të shkollës 9-vjeçare “Servete Maçi” me temë “Paraja: Ç’të mbjellësh do të korrësh!”.

Ora 11:00, Tiranë

Vizitë në një degë banke tregtare

ProCredit Bank vë në dispozicion për nxënësit e një shkolle të mesme degën e saj tek Tirana e Re për të vizituar Zonën 24/7 të bankës. Nxënësit mund të njihen konkretisht me shërbimet inovative bankare të ofruara 24/7 dhe mësojnë avantazhet që sjell për klientët automatizimi i shërbimeve bankare.

Ora 14:00, Tiranë

Leksion i hapur në Universitetin Epoka, Tiranë nga zj. Olta Manjani, kryespecialiste pranë Departamentit të Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë, me temë “Sistemi monetar dhe roli i Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e tij” dhe zj. Suela Totokoci, Drejtore e Departamentit të Thesarit, Intesa Sanpaolo Bank, me temë “Roli i bankave në transmetimin e politikës monetare. Përdorimi i monedhës vendase”.

Ora 18:00, Tiranë

Leksion i hapur në Bankën e Shqipërisë me temë, “Rëndësia e kulturës financiare për sipërmarrësit e rinj dhe për mirëqenien personale”. Leksioni do të mbahet nga z. Dritan Mezini, Drejtor i Përgjithshëm i DM-consulting dhe portalit Duapunë.com.

E mërkurë, 14 mars 2018

Dita e Verës –festë zyrtare

E enjte, 15 mars 2018

Ora 09:00, Tiranë

Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe orë mësimore për nxënës të ciklit fillor të shkollës 9-vjeçare “Servete Maçi” me temë “Paraja: Ç’të mbjellësh do të korrësh!”.

Ora 10:00, Tiranë

Ky aktivitet është një version i lojës së Tregtisë Ndërkombëtare dhe do të zhvillohet në sallën e konferencave Protik me pjesëmarrjen e 30 nxënësve (17-18 vjeç) që vijnë nga Tirana. Nxënësit ndahen në ekipe të përbëra



prej pesë personash dhe secili prej tyre vepron si një "vend" i veçantë. Vendet klasifikohen sipas nivelit të të ardhurave (të larta, mesatare dhe të ulëta) dhe konkurrojnë kundër njëri-tjetrit "për të prodhuar" forma letre (rrethore, trekëndësha, drejtkëndësha etj.) me qëllim shitjen e tyre tek një tregtar që operon në treg ndërkombëtar, me çmime që variojnë sipas kërkesës dhe ofertës. Loja udhëhiqet nga një lektor dhe çdo ekip ndihmohet nga një vullnetar i biznesit, i cili vjen nga industria bankare dhe bizneset që veprojnë në Shqipëri. Objektivi për secilin vend është që të bëjë sa më shumë pará. Bazuar në të ardhurat e grumbulluara do të shpallet ekipi fitues. (Junior Achievement)

E premte, 16 mars 2018

Ora 11: 30, Tiranë

Kuizi Evropian i Parasë (European Money Quiz), i cili zhvillohet për herë të parë në vitin 2018, si një konkurs mbarë evropian me qëllim përmirësimin e kulturës financiare të fëmijëve të moshës 13 - 15 vjeç. Klasat e 9-ta do të konkurrojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin gjatë një aktiviteti "live", në platformën Kahoot! ora 11:30, në Tiranë, në qendrën kulturore Ortodokse. Klasa më e zgjuar dhe më e shpejtë, do të duhet t'i përgjigjet saktë dhe shpejt 10 pyetjeve të konkursit kombëtar. Çdo klasë do të përfaqësohet nga një skuadër me 5 nxënës. Nga skuadra fituese e fazës së parë, dy më të mirët do të vijojnë në fazën e dytë, në Bruksel ndërsa 3 nxënësit e tjerë të skuadrës do të vlerësohen me dhurata simbolike.

Ora 11:00, Durrës,

Leksion i hapur në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, nga: 1. zj. Ela Golemi, anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Zëvendësdekane në Fakultetin e Kërkimit Shkencor të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, me temë "Rëndësia e përdorimit të monedhës sonë kombëtare në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit"; 2. zj. Elona Barxhani, Drejtore e degës së Credins Bank në Durrës me temë "Veprimtaria bankare me pakicë (*retail*): dhënia e kredive dhe depozitave në monedhën vendase".

Ora 10:30, Elbasan

Leksion i hapur në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan nga: 1. Juna Bozdo, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit Sistemik, të Departamentit të Stabilitetit Financiar në Bankën e Shqipërisë, me temë "Stabiliteti financiar, roli i Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e tij dhe paketa e deeuroizimit"; 2. Artiola Agalliu, Drejtore e Departamentit të Menaxhimit të Riskut, Union Bank, me temë "Stabiliteti financiar, roli i bankave"; 3. Marilda Shkurti Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), me temë "Stabiliteti financiar, roli i skemave të sigurimit të depozitave në ruajtjen e stabilitetit financiar".

Ora 17:00, Tiranë

Leksion i hapur në UET nga znj. Ediola Bicaku, Drejtuese e Departamentit të Auditit të Brendshëm në Intesa Sanpaolo Bank Albania, me temë "Internal Audit in Banking Sector & Future Challenges".